

# BOTASOT

## Buhler: Nëse nuk ka dëshmi për akuzat e Martit, ato janë shpifje

**PRIZREN, 21 DHJETOR** ■ Komandanti i KFOR-it, gjermani Erhard Buhler, tha se Dick Marty, raportuesi i Këshillit të Evropës, duhet të paraqet dëshmi rreth raportit të tij skandaloz për Kosovën, ose në të kundërtën Buhler, ato që thuheshin në këtë raport i ka cilësuar si shpifje ndërsa individët që akuzohen janë të pa fajshëm. Buhler theksoi se raporti nuk ka asnjë ndikim në Kosovë, dhe si-tuatën e ka vlerësuar si tejet të qetë, duke mohuar se do të ndikoj negativisht në raportet mes Gjermanisë dhe Kosovës. "Ky raport nuk ka kurrfarë ndikimi në gjendjen në Kosovë, jo vetëm pjesërisht, por mund të them për gjithë territorin e Kosovës. Kosova është e qetë pas zgjedhjeve si kurrë më parë. Sa i përket rapor-



institucionet përkatëse. Unë kam besim të plotë se kjo do të ndodh dhe në atë rast duhet të merren vendime të prera dhe të shpejta", ka theksuar Buhler. Buhler gjithashtu pohoi se ky raport nuk do të ndikoj në raportet mes Gjermanisë dhe Kosovës.

"Nuk do të ketë kurrfarë ndikimi në raportin e Gjermanisë dhe Kosovës. Ajo çfarë duhet të pranojmë është se vërtet po dëmtohet imazhi i Kosovës, para se gjithash tek ata që lexojnë gazeta dhe nuk e njohin Kosovën. Mirëpo në aspektin afatgjatë nuk do

të thotë asgjë, sepse Kosova ka përjetuar shumëçka tjetër, shumë gjëra më të këqija, pra kjo është e tejkulluar", ka spikatur Buhler.

Ai ka thënë se gjendje në Kosovë në sferën e sigurisë është stabile dhe se për këtë KFOR po bënë reduktimin e trupave. "Mund të thuhet se vërtet gjendja është stabile dhe për këtë arsye kjo gjendje na mundëson reduktimin e trupave të KFOR-it që jemi duke bërë. Mirëpo edhe pse gjendja është stabile nuk do të thotë që kjo gjendje është e pakthyeshme dhe për këtë arsye qëndrojmë edhe më tej të gatshëm edhe me forcat mobile. Simjali është i qartë se situata është e qetë, mund t'i re-duktojmë forcat dhe kjo na bënë të jemi të lumtur", tha Buhler gjatë qëndrimit në Prizren. ■